



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 7618 prot.

Shkodër, më 10.4. 2025

**VENDIM**

**Nr. 24, datë 08.04.2025**

**“PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË SHKODËR, SË BASHKU ME  
DOKUMENTACIONIN TEKNIKO-LIGJOR PËR AKORDIMIN E NDIHMËS  
FINANCIARE PËR FAMILJEN E GJIN RRAHISHTA, BARDHYL TOKA DHE  
MARTIN TATGJONAJ, BANESA E TË CILËVE ËSHTË DËMTUAR NGA ZJARRI”**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 08.04.2025 me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; Ligjin nr. 45/2019, “Për Mbrojtjen Civile”; Ligjin nr.68/2017 “Për financat vendore”, i ndryshuar; VKM-në nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”; VKM-në nr. 414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, i ndryshuar; VKB-në nr 76, datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë së Shkodrës” i ndryshuar, si dhe dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër;

**VENDOSI:**

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare të familjes së **Gjin Rrahishta** (3 anëtarë familje), në vlerën prej 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë ( sipas certifikatës familjare të paraqitur), për dëmtimin e banesës së tyre nga zjarri.
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e **Gjin Rrahishta** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore prej 220 445 (dyqind e njëzet mijë e katërqind e dyzet e pesë) lekë dhe për dëmet në orendi prej 162 600 (njëqind e gjashtëdhjetë

- e dy mijë e gjashtëqind) lekësh, sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e **Gjin Rrahishta**.
3. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare të familjes së **Bardhyl Toka** (4 anëtarë familje), në vlerën prej 80 000 (tetëdhjetë mijë ) lekë ( sipas çertifikatës familjare të paraqitur), për dëmtimin e banesës së tyre nga zjarri .
  4. Për familjen e **Bardhyl Toka** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore prej 184 110 (njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e njëqind e dhjetë) lekë dhe për dëmet në orendi prej 0 (zero) lekë , sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e **Bardhyl Toka**.
  5. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare të familjes së **Martin Tatgjonaj** (5 anëtarë familje), në vlerën prej 100 000 (njëqind mijë) lekë ( sipas çertifikatës familjare të paraqitur), për dëmtimin e banesës së tyre nga zjarri .
  6. Për familjen e **Martin Tatgjonaj** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore prej 504 128 (pesëqind e katër mijë e njëqind e njëzet e tetë) lekë dhe për dëmet në orendi prej 121 600 (njëqind e njëzet e një mijë e gjashtëqind) lekë , sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e **Martin Tatgjonaj**
  7. Burimi i financimit të jetë fondi i emergjencave civile parashikuar në programin **AB141** “ Siguria Publike dhe Mbrojtja Civile” në buxhetin e Bashkisë Shkodër për vitin 2025 të miratuar me VKB Nr 76 datë 19.12.2024 “ Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë së Shkodrës”, i ndryshuar, në programin **AB141, Q2 O1 A4** “ Përballimi i ndihmave të menjëhershme për familjet me raste fatkeqësie”, në vlerën 240 000 (dyqind e dyzetmijë ) lekë. Ngarkohet administrata e Bashkisë Shkodër për likuidimin e ndihmës së menjëhershme.
  8. Për familjen e **Gjin Rrahishta, Bardhyl Toka dhe Martin Tatgjonaj** kompensimi i dëmeve materiale ndërtimore dhe në orendi e pajisje do të bëhet sipas preventivave të vlerësimit hartuar nga grupi i verifikimit dhe vlerësimit, në zbatim të Ligjit 45/2019 “ Për Mbrojtjen Civile “ neni 41 , të VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 pika 3 dhe të VKM-së Nr. 414 datë 08.07.2021 pika 3.1/a “ Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të Buxhetit të Shtetit për Mbrojtjen Civile “, sipas Relacionit bashkëngjitur, në masen 50 % të vlerës ndërtimore në shumën **454 341,5** (katërqind e pesëdhjetë e katër mijë e treqind e dyzet e një presje pesë) lekë dhe në masen 50% të vlerës së orendive në shumën **142 100** (njëqind e dyzet e dy mijë e njëqind) lekë.

9. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

10. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miratuar me **38** vota

Vota Pro 38

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 08.04.2025

**SEKRETARE**

**Sabina Danaj**



**KRYETAR**

**Olton LULI**

